

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7059  
E enjte, 30 nëntor 2023  
Çmimi 0.50 €

## Blinkeni: Nuk duam rikthim të konflikteve në Ballkan



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TYM DHE ARRESTIME NË PROTESTËN KUNDËR KRYETARES SË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA, EKATERINA TRENDAFILOVA

# 'POSHTË GJYKATA SPECIALE', 'UÇK-ja NUK MUND TË GJYKOHET'

## OPINION

### GJYKATA SPECIALE E KOSOVËS, TEATËR PA PUBLIK

Nga: Bekim ÇOLLAKU



## AKTUALE



### PASAPORTAT E KOSOVËS PËR SERBËT, ÇËSHITJE INTEGRIMI APO ZGJEDHJEJE

### AKTAZË KUNDËR NJË SERBI TË DYSHUARI PËR MASAKRËN NË BURGUN E DUBRAVËS

## EKONOMI



### PARATË E FALSIFIKUARA, ISH-GUVERNATORI I BQK-së: QYTETARËT DUHET T'I SHMANGIN PAGESAT ME 'CASH'

## SPORT



### ZYBERAJ: VRAPOVA PËR SHPIRTIN E BABAIT. MA LA AMANET



Partia Socialdemokrate (PSD) e ka pritur me protestë kryetaren e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, gjatë vizitës së saj në Kosovë të mërkurën. Me thirrjen

"Poshtë Gjykata Speciale", "UÇK-ja nuk mund të gjykohej", aktivistët e PSD-së kanë protestuar përpara hotelit "Sirius" në Prishtinë, në të cilin Trendafilova mbante takim me

shoqërinë civile. Protesta ka eskaluar pasi policia ka hedhur gaz lotsjellës e më pas ka arrestuar gjashtë aktivistë të PSD-së, në mesin e të cilëve edhe Dardan Molliqaj

## Reagim i KMDLNj-së PSE NUK DUHET TË VOTOHET TRAKTATI PËR BURGJE MË DANIMARKËN?



## IMPORTI I PRODUKTEVE SHQIPTARE NË KOSOVË RRIET PËR DHJETËRA MILIONA EURO



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

# Blinkeni: Nuk duam rikthim të konflikteve në Ballkan

WASHINGTON, 29 NËNTOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se gjatë takimit të Bruksel të ministrave të Jashtëm të NATO-s, kanë diskutuar për rolin e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në promovimin e paqes.

Kryediplomati amerikan tha se gjëja që nuk duan të shohin në këtë rajon është rikthimi i konflikteve. "Kur kam nisur këtë karrierë në qendër të shqetësimeve tona ka qenë Ballkani. Në qendër të shqetësimit tonë dhe të shqetësimeve të shteteve në mbarë botën, veçmas në zonën transatlantike, ishte Ballkani, Bosnja dhe më pas Kosova. Një gjë që ne nuk duam të ndodhë në të ardhmen është kthimi i konflikteve në Ballkan. NATO ka luajtur rol kyç që të ndihmojë shtetet e rajonit të bëjnë përparim në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në stabilitetin më të



gjërë evropian", tha ai, duke shtuar se NATO për një kohë të gjatë është shtyllë e sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Blinkeni foli edhe për tensionet në veri të Kosovës të banuar me shumicë serbe, që kanë nisur në maj dhe që kanë kulmuar në shtator, pasi një grup i armatosur serbësh kreu sulm të armatosur

ndaj Policisë së Kosovës.

Më 24 shtator grupi i armatosur i serbëve vrau rreshterin Afrim Bunjaku, ndërkaq në përlëshjet e armatosura që u zhvilluan gjatë ditës në Banjskë të Zveçanit, u vranë edhe tre sulmues serbë. "Aleanca është përgjigjur me vendosmëri ndaj aktorëve që synojnë të destabilizojnë veriu e

Kosovës. Siç e kemi edhe më herët gjatë këtij viti, me kemi dislokuar trupa shtesë në [misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë] KFOR. Po ashtu, kemi thelluar bashkëpunimin tonë me forcën e udhëhequr nga Bashkimi Evropian në Bosnjë-Hercegovinë. Kjo, po ashtu, ishte pjesë e rëndësishme e bisedës sonë gjatë këtyre dy ditëve", tha Blinken.

Një ditë më herët sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, shprehu shqetësimin për rritjen e tensioneve në Ballkanin Perëndimor. Ai premtoi se aleanca do të bëjë gjithçka në mënyrë që të ruajë stabilitetin në rajon.

Shefi i NATO-s ka paralajmëruar se në takimin e 28 dhe 29 nëntorit në Bruksel do të diskutohet mundësia e shtimit të përhershëm të numrit të ushtarëve në kuadër të misionit paqeruajtës të aleancës në Kosovë, KFOR.

Pas sulmit në Banjskë, NATO ka forcuar tashmë praninë e saj ushtarake në Kosovë - e krijuar pas fushatës së bombardimeve kundër Serbisë në vitin 1999 - me rreth 1 000 trupa shtesë dhe armatime më të rënda, duke çuar trupat e saj në Kosovë në 4 500.

Sulmi në Banjskë për të cilin Kosova e fajëson Serbinë është dënueshëm nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-ndërkryetar i Listës Serbe. Autoritetet në Kosovë dhe Serbi po zhvillojnë hetime të ndara për këtë ngjarje, përderisa Prishtina ka kërkuar ekstradimin e Radoičiqit.

Faktori ndërkombëtar, ndërkaq, u ka bërë thirrje palëve të mos nxisin tensionet dhe të rikthehen në dialogun për normalizimin e raporteve, që ndërmjetësohet nga BE-ja dhe mbështetet nga ShBA-ja.

## G7 kërkon zgjatjen e armëpushimit në Gazë

OTTAWA, 29 NËNTOR - Ministrat e Jashtëm të Grupit të Shtatë shteteve më të industrializuara (G7) kanë mbështetur zgjatjen e mëtejme të ndalimit aktual të luftimeve në Gazë.

Përmes një deklarate për media, G7 tha se pauzat e reja të armëpushimit do të duhej të përfshinin edhe rritjen e ndihmës dhe lehtësimin për lirin e të gjitha pengjeve të marra nga Hamasi - grupi militant palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Çdo përpjekje duhet të bëhet duke u siguruar mbështetja humanitare për civilët... Ne mbështesim zgjatjen e mëtejme të kësaj pauze dhe pauzat e ardhshme duhet të lejojnë që ndihma të rritet dhe të lehtësohet liri i të gjitha pengjeve", u tha në deklaratën e përbashkët të ministrave të Jashtëm të G7-s.

Armëpushimi aktual në mes të Izraelit dhe Hamasit, grup radikal që udhëheq Gazën, është

armëpushimi i parë pas shtatë javësh luftë, që ka rrafshuar Rripin e Gazës dhe ka lënë të vrarë mbi 15 000 persona, sipas zyrtarëve shëndetësorë në këtë territor.

Lufta Izrael - Hamas u nxit pasi grupi radikal palestinez sulmoi jugun e Izraelit më 7 tetor, duke vrarë 1 200 persona dhe duke zënë peng afër 240 të tjerë.

Armëpushimi aktual parasheh lirin e pengjeve nga Hamasi në këmbim të lirit të të burgosurve palestinezë nga Izraeli.

Në deklaratën e G7-s, po ashtu, u mirëprit liri i pengjeve nga Hamasi.

Hamasi ka liruar edhe 12 pengje të tjera më 28 nëntor, ndërkaq Izraeli ka liruar 30 të burgosur palestinezë. Armëpushimi aktual pritet të përfundojë të enjten.

Numri i përgjithshëm i pengjeve të liruara që nga e premta - kur nisi armëpushimi - është 81, ndërkaq Izraeli ka liruar 180 të burgosur. "Ne si G7 bëjmë thirrje për lirin e menjëhershëm dhe pa kushte të të



gjitha pengjeve", u tha në deklaratën e G7-s.

Në deklaratë, po ashtu, u theksua "e drejta e Izraelit për ta mbrojtur veten dhe popullin e tij", po ashtu u tha se është e rëndësishme "që të

mbrohen civilët dhe të respektohen ligjet ndërkombëtare". Ministrat e G7-s thanë se janë të përkushtuar për krijimin e një shteti palestinez përmes zgjidhjes me dy shtete. Ata, po ashtu,

kërkuar që të mos lejohet që konflikti të përshkallëzohet edhe më tej. Në G7 bëjnë pjesë: Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian.

## Finlanda mbyll kufirin me Rusinë për shkak të emigrantëve



HELSINKI, 29 NËNTOR - Finlanda ka njoftuar se pika e fundit kufitare me Rusinë do të mbyllet të enjten, mes shqetësimeve se Moska po i shfrytëzon emigrantët si pjesë e një "luftë hibride" për destabilizimin e vendit nordik, pas anëtarësimit të tij në NATO.

Kryeministri finlandez Petteri Orpo ka akuzuar Moskën se qëndron prapa shtimit jashtëzakonisht të madh të

azilkërkuesve. "Informacionet e inteligjencës, nga burime të ndryshme, na thonë se ka ende njerëz në lëvizje... Nëse kjo vazhdon, do të merren më shumë masa në të ardhmen e afërt", tha Orpo në një konferencë për media më 27 nëntor.

Sipas Rojës Kufitare finlandeze, rreth 900 azilkërkues nga vende si Afganistani, Kenia, Maroku, Pakistani, Somalia, Siria dhe

Jemeni hynë në Finlandë nga Rusia gjatë nëntorit, që paraqet rritje të theksuar krahasuar me hyrjen e disa emigrantëve në ditë, një muaj më parë.

Helsinki akuzon Moskën se i ka dërguar emigrantët drejt kufirit në shenjë hakmarrjeje për vendimin e tij për të rritur bashkëpunimin në mbrojtje me Shtetet e Bashkuara, akuzë e cila mohohet nga Kremli.

TYM DHE ARRESTIME NË PROTESTËN KUNDËR KRYETARES SË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA, EKATERINA TRENDAFILOVA

# 'Poshtë Gjykata Speciale', 'UÇK-ja nuk mund të gjykohet'

Partia Socialdemokrate (PSD) e ka pritur me protestë kryetaren e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, gjatë vizitës së saj në Kosovë të mërkurën. Me thirrjen "Poshtë Gjykata Speciale", "UÇK-ja nuk mund të gjykohet", aktivistët e PSD-së kanë protestuar përpara hotelit "Sirius" në Prishtinë, në të cilin Trendafilova mbante takim me shoqërinë civile. Protesta ka eskaluar pasi policia ka hedhur gaz lotsjellës e më pas ka arrestuar gjashtë aktivistë të PSD-së, në mesin e të cilëve edhe Dardan Molliqaj

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Partia Socialdemokrate (PSD), e cila nuk përfaqësohet në Kuvendin e Kosovës, ka protestuar të mërkurën kundër vizitës në Kosovë të kryetares së Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, duke hedhur bomba tymuese që krijuan tym të madh të zi pranë hotelit "Sirius" në Prishtinë, në të cilin ajo po mbante takim me shoqërinë civile. Sipas PSD-së, Policia e Kosovës gjatë protestës i arrestoi gjashtë anëtarë të saj, përfshirë edhe kryetarin e saj Dardan Molliqaj. "Në kundërshtim të Gjykatës Speciale, gjatë protestës së PSD-së janë arrestuar gjashtë aktivistë: kryetari Dardan Molliqaj, Zgjim Hyseni, Nol Nushi, Korab Korça, Agron Kabashi dhe Gent Ibrahim", ka njoftuar PSD-ja. Sipas PSD-së, një gjykatë e padrejtë, siç është Gjykata Speciale, nuk mund të sillt ndryshe përveçse dhunshëm. "Kështu është krijuar, dhunshëm po e bën procesin e gjykimin dhe me të njëjtën mënyrë po përpigjet t'i frikësojë të gjithë ata që e kundërshtojnë. PSD-ja nuk zmbrazet para asnjë metode jodemokratike", është theksuar në njoftimin e PSD-së.


Policia e Kosovës nuk është pronuar lidhur me këtë. "Kjo është përpjekje për disiplinim dhe përmirësim imazhi për gjykatën e padrejtë speciale", ka shkruar PSD-ja në "Facebook". Duke folur para përshkallëzimit të protestës, kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, tha se u mbledhën përballë hotelit për ta kundërshtuar vizitën e Trendafilovës në Kosovë. "Sa herë që kemi qenë më afër Serbisë dhe marrëveshjeve të këqija me Serbinë, ka pasur përndjekje të UÇK-së. Gjykata e ka në mandat ta ndjekë vetëm UÇK-në, është më e keqe se njëetnike. Ne duhet dhe do ta pengojmë këtë takim. Takimi ka filluar ndërsa ne e vazhdojmë



protestën", ka thënë Molliqaj. Protestuesit mbanin në duar pankarta me mbishkrimet "UÇK-ja nuk mund të gjykohet", "UÇK-ja është përpjekja për liri", dhe "Trendafilova out", si dhe brohoritën "Poshtë Gjykata Speciale".

Partia Socialdemokrate ka protestuar kundër Trendafilovës edhe në të kaluarën. Gjykata Speciale apo Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Gjykata Speciale është themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë. "Druajtja nga frikësimi i dëshmitarëve ka qenë një prej arsyeve përse kjo gjykatë e Kosovës është vendosur në Hagë dhe jo në Prishtinë", kishte thënë Qeveria e Holandës në një deklaratë të lëshuar në vitin 2016. Aktualisht në Dhomat e Specializuara janë duke u

zhvilluar disa raste gjyqësore, përfshirë edhe atë ndaj ish-kryerëve të UÇK-së Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi që akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Deri më tani Gjykata Speciale i ka dënuar dy pjesëtarë të OVL së UÇK-së, Nasim Haradinajn dhe Hysni Gucatin, në maj të vitit 2022, për pengim të administrimit të drejtësisë. Dënimi fillestar për secilin ka qenë 4 vjet e gjysmë burgim, ndërsa pas ankesës në Apel koha u është zvogëluar në 4 vjet e tre muaj burgim. Shumë në Kosovë e shikojnë Gjykatën Speciale si të padrejtë sepse, siç thonë, do t'i gjykojë vetëm pjesëtarët e një grupi etnik, në këtë rast shqiptarët, ndërsa krimet e supozuara të serbëve do të mbeten të pandëshkuara.





# Pasaportat e Kosovës për serbët, çështje integrimi apo zgjedhjeje

Prishtinë, 29 nëntor - Filipi nga Mitrovica e Veriut beson se Qeveria e Kosovës, "për arsye politike", ka kërkuar nga Komisioni Evropian që të mos e lejojë liberalizimin e vizave për pasaportat e Administratës Koordinuese të lëshuara nga Serbia. "Nuk mendoj se kanë ndonjë arsye [tjetër] për ta kundërshtuar atë; është një gjë pozitive", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë kanë të drejtën e shtetësisë serbe dhe, bashkë me të, të drejtën për të pasur pasaportë edhe të Kosovës, edhe të Serbisë. Megjithatë, Filipi ka vetëm pasaportën e Administratës Koordinuese dhe thotë se nuk ka dashur ta marrë atë të Kosovës, sepse shpreson se do të mund të udhëtojë pa viza edhe me pasaportën e Serbisë.

Qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në shtetet evropiane - të njohura si zona Schengen - nga 1 janari i vitit të ardhshëm.

Serbia ka fituar liberalizimin e vizave në vitin 2009, por me kushtin që të mos zbatohet për poseduesit e pasaportave që i lëshon ajo për qytetarët me vendbanim në Kosovë.

## A e dëmton propozimi i Komisionit Evropian integrimin e serbëve?

Pasi Komisioni Evropian paralajmëroi në prill të këtij viti se liberalizimi i vizave, i miratuar për Kosovën, vlen vetëm për poseduesit e pasaportave të Kosovës, i njëjti organ - në mes të nëntorit - dha rekomandimin për heqjen e vizave edhe për poseduesit e pasaportave të Administratës Koordinuese, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Qeveria e Kosovës shprehu më pas "shqetësimin" e saj për një propozim të tillë pa konsultime apo njoftim paraprak.

Prishtina zyrtare nuk i njeh pasaportat serbe të Administratës Koordinuese, sepse e konsideron atë si institucion ilegal. "Njohja e këtyre dokumenteve cenon integrimin e komunitetit serb, dëmton përpjekjet tona afatgjate [për integrimin e serbëve]", shkroi zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, në një postim në llogarinë e tij në "Facebook", më 21 nëntor.

Ai, gjithashtu, tha se pjesëtarët e komunitetit serb me pasaporta të

Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm në Zonën Shengen.

Më 24 nëntor Komisioni Evropian nuk iu përgjigj konkretisht pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" lidhur me vërejtjet e Qeverisë së Kosovës, por tha se do t'u përgjigjet.

## A kontribuojnë pasaportat e Kosovës në integrimin e serbëve?

Petri nga Graçanica - komunë me shumicë serbe afër Prishtinës - ka edhe pasaportë kosovare, edhe serbe. Ai beson se marrja e ndonjë dokumenti të Kosovës nuk do të thotë integrim thelbësor në sistemin apo shoqërinë e Kosovës por se, sipas tij, ka të bëjë me "arsye praktike" ose "pamundësi zgjedhjeje". "Njerëzit duhet të kenë zgjedhje dhe mundësi të barabarta. Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për t'i integruar serbët duke ofruar cilësi më të mira të jetesës, jo me shantazhe ose duke i kufizuar zgjedhjet", thotë Petri për "Radion Evropa e Lirë".

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, të cilat i janë ofruar REL-it në fund të tetorit, kërkesat për

pasaporta të Kosovës në komunitetet serbe janë rritur gjatë këtij viti.

Interesim të veçantë ka pasur në komunat në veri të Kosovës. Për shembull, në periudhën nga 1 janari 2023 deri më 30 korrik 2023, numri i kërkesave për pasaportë të Kosovës është rritur për 97 për qind në Leposaviq.

## Çfarë thotë sektori civil?

Sektori civil shqiptar dhe ai serb në Kosovë kanë pikëpamje krejtësisht të kundërta për këtë çështje.

Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, beson se pajisja me pasaporta lidhet drejtpërdrejt me integrimin e serbëve të Kosovës në shoqërinë dhe sistemin kosovar dhe thotë se ky është standard që vlen në të gjitha shtetet demokratike. "Është një vlerë dhe një parim që duhen mbrojtur dhe zbatuar", thotë Miftaraj për "Radion Evropa e Lirë".

Marrja e shtetësisë së një vendi, shton ai, u mundëson qytetarëve t'i ushtrojnë të drejtat e tyre, siç është e drejta e votës. "Kjo lidhje mes shtetit dhe qytetarëve krijon një ndjenjë të interesit të ndërsjellë, ose më saktë, një

ndjenjë të thellë të lidhjes mes qytetarëve dhe vetë shtetit", thotë Miftaraj.

Por, Jovana Radosavleviq, drejtoreshë e Iniciativës së Re Sociale, thotë se "të kesh një pasaportë të caktuar nuk do të thotë integrim". "Më duhet të theksoj se problem i madh me të cilin përballemi, është politizimi i çështjes së lëvizjes së lirë të njerëzve. Shtetasit e Kosovës kanë të drejtën e shtetësisë së dyfishtë - pasaportën mund ta marrin, por nuk e kanë të domosdoshme. Po kështu, nëse dikush është edhe shtetas i Serbisë, ai mund t'i marrë të dyja pasaportat, mund ta marrë ose njërën, ose në fund të fundit asnjërën", thotë Radosavleviq për REL-in.

Ajo, po ashtu, kujton se sektori civil shqiptar ka qenë i pari që ka kundërshtuar propozimin e KE-së për heqjen e vizave për pasaportat e lëshuara nga Administrata Koordinuese dhe konsideron se diçka e tillë është "shqetësuese".

## Çështja e pasaportave serbe "ndan" sektorin civil

Më 21 nëntor, një grup prej rreth 20 organizatash joqeveritare nga

# Importi i produkteve shqiptare në Kosovë rritet për dhjetëra miliona euro



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Vlera e produkteve nga Shqipëria, të importuara në Kosovë, është rritur për më shumë se 55 milionë euro në periudhën janar-shtator të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës, të siguruar nga "Radio Evropa e Lirë", flasin edhe për rritje të eksporteve nga Kosova në Shqipëri - nga 77 milionë euro sa ishin në periudhën janar-shtator të vitit 2022, në 82 milionë euro gjatë së njëjtës periudhë të këtij viti. Nga Shqipëria në Kosovë, në periudhën janar-shtator të këtij viti, kanë hyrë rreth 55 milionë euro produkte më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e importeve në këta muaj ka tejkaluar shumë prej 238.9 milionë eurosh, ndërsa në vitin 2022 ka qenë mbi 183 milionë euro. Por, cila është arsyeja e rritjes së shkëmbimeve tregtare mes dy

shteteve? Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, e lidh atë me ndalimin e produkteve të Serbisë në tregun e Kosovës. Si rrjedhojë, thotë ai, bizneset e Kosovës janë orientuar nga produktet e Shqipërisë për shkak të afërsisë gjeografike. Qeveria e Kosovës i ka ndaluar pothuajse të gjitha importet nga Serbia qysh më 15 qershor, kur forcat serbe kanë arrestuar tre policë të Kosovës. Ndërkohë që policët janë liruar për t'u mbrojtur në liri, masa e ndalesës së prodhimeve ka vazhduar. Kosova importon shumicën e produkteve nga vendet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian. Në vitin 2022, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave në vend, Kosova ka importuar produkte në vlerë mbi 5 miliardë euro, ndërsa ka eksportuar produkte në vlerë afër 1 miliard euro.

## Barrierat Kosovë - Shqipëri

Ndër vite Kosova dhe Shqipëria kanë arritur dhjetëra marrëveshje për thjeshtësimin e procedurave doganore dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik, por përfaqësuesit e bizneseve nga të dyja anët thonë se shumë prej tyre nuk zbatohen në praktikë. Ata ankohen për një sërë barrierash - nga pritjet e gjata në kufi deri te skanimi i produkteve. Bedri Kosumi, pronar i kompanisë "Pestova" që merret me prodhimin dhe përpunimin e patates, thotë se që 20 vjet eksporton në Shqipëri produktet "Vipa Chips", ndërsa importon prej atje lëndën e parë. Deri më tash këtë vit ai thotë se ka eksportuar në shtetin fqinj produkte në vlerë prej një milion eurosh. "Për çdo eksport, autoritetet shqiptare kërkojnë

kopjen e noterizuar të certifikatës së cilësisë së produktit. Skanimi i mauneve për të kontrolluar mallin brenda është i mundimshëm dhe i kushtueshëm - 22 euro pa nevojë. Kamionët ende presin me orë të tëra në kufi - gjë që ka kosto monetare dhe është shumë humbje kohe", thotë Kosumi për "Radion Evropa e Lirë". Rafuna konfirmon se për noterizimin e certifikatës së cilësisë, ankesa në Odën Ekonomike të Kosovës ka edhe nga kompani të tjera. Sipas tij, kjo kërkesë që bëhet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të Shqipërisë është e padrejtë pasi, siç thotë, autoritetet e Kosovës nuk ua kërkojnë një dokument të tillë kompanive të Shqipërisë. Por, ankesa ka edhe prej tyre. Kryetari i Shoqatës së Eksportuesve Shqiptarë, Alban Zusi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se, përkundër disa

përmirësimeve të vogla, ka ende barriera që e pengojnë eksportin mes dy vendeve.

Si përmirësim ai e konsideron heqjen e marrjes së lejes për produktet ushqimore nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës e Kosovës - leje kjo e nevojshme deri para një viti.

Por, shton ai, çdo produkt me certifikatë veterinarë në Shqipëri, duhet ta marrë një të tillë edhe në Kosovë dhe anasjelltas. "Kjo certifikatë kushton 30 euro, kurse ka kompani që eksportojnë çdo ditë produkte ushqimore të freskëta", thotë Zusi. "Barrierë tjetër është koha, e cila do të duhej të ishte aq sa bën rruga, pra tri orë. Por, kjo mund të shkojë edhe në 24 orë për shkak të kontrolleve, radhëve, faktit se nëse arrin pas orës 18:00, nuk i kryen dot procedurat [doganore] dhe shoferi i kamionit duhet ta presë mëngjesin e ditës së nesërme", shton ai.

Zusi thotë se të gjitha dokumentet doganore dhe certifikata për produkte veterinarë arrijnë shumën deri në 200 euro.

"Radio Evropa e Lirë" kërkoi koment nga Ministria e Tregtisë e Kosovës në lidhje me këtë temë, por ky institucion nuk u përgjigj. Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP, me seli në Prishtinë, ka bërë një sërë hulumtimesh për këtë çështje. Në vitin 2020 ai ka gjetur se bizneset e Kosovës paguajnë rreth dy milionë euro në vit vetëm për skanimin e mallit përpara se të hyjnë në Shqipëri. Sipas Rafunës, shumë pak gjëra kanë ndryshuar ndërkohë, ndërsa thotë se ka shumë hapësirë për bashkëpunim më të ngushtë mes dy vendeve.

Në një forum që u mbajt këtë javë në Gjakovë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se investimet direkte nga Shqipëria në Kosovë janë rritur në vitin 2022 në gati 80 milionë euro, nga mbi 15 milionë sa kanë qenë në vitin 2019.

komuniteti shqiptar, përfshirë Institutin e Kosovës për Drejtësi, vlerësoi se heqja e vizave për pasaportat e Administratës Koordinuese do ta dëmtonte procesin e integritit të serbëve, veçanërisht atyre që jetojnë në veri të Kosovës. Grupi theksoi se nëse propozimi miratohet, ai do ta dëmtojë rëndë qëllimin dhe zbatimin e Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të cilën dy vendet kanë rënë dakord në fund të shkurtit të këtij viti. Me këtë rast u vu theksi te pika e Marrëveshjes lidhur me respektimin e integritetit territorial dhe sovranitetit të të dyja palëve. Disa orë më vonë reagoi sektori civil serb në Kosovë, duke e konsideruar "fyes" qëndrimin e kolegëve nga komuniteti

shqiptar. Sipas tij, marrja e pasaportave të Kosovës nuk nënkupton në asnjë mënyrë integritimin e serbëve në shoqërinë dhe sistemin kosovar. "Asnjë serb i Kosovës më shumë nuk do të integrohet nëse i jepet pasaporta e Kosovës... Kjo rrjedh nga fakti se pasaporta nuk mund të merret pa letërnjoftim dhe dëshmi të shtetësisë. Me fjalë të tjera, një person që merr pasaportën e re tashmë ka nënshtetësinë dhe kështu është i integruar", thuhet në reagimin e nënshkruar nga rreth 15 organizata, mes tyre edhe Nisma e Re Sociale. Një tjetër reagim i hapur nga të dyja palët pasoi më 24 nëntor, ndërsa për këtë javë u thirr një takim i përbashkët, në të cilin sektori civil shqiptar dhe ai serb do të bisedojnë për çështjet e diskutueshme.

## A është Administrata Koordinuese institucion paralel?

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i bëri thirrje BE-së që dokumentet e lëshuara nga Serbia për qytetarët e Kosovës, t'i trajtojë si të paligjshme. Jovana Radosavleviq, nga Iniciativa e Re Sociale, thotë se KE-ja duhet të konkludojë nëse Administrata Koordinuese është institucion i paligjshëm ose jo, por nënvizon se, aktualisht, ajo është i vetmi organ që mund të lëshojë pasaporta për qytetarët serbë që banojnë në Kosovë, apo për personat e zhvendosur nga Kosova. "Nëse ky organ do të shfuqizohet, këta shtetas do të privoheshin nga të drejtat e tyre, në kuptimin që nuk do të mund të udhëtojnë, edhe pse kjo

pasaportë [e lëshuar nga Administrata Koordinuese] kërkon ende vizë", thotë ajo. Por, Ehat Miftaraj, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, thotë se Administrata Koordinuese është një mekanizëm i paligjshëm dhe se është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. "Gabimi apo praktika jo e duhur e Komisionit Evropian në vitin 2009, nuk mund të legjitimohet dhe legalizohet. Ky mekanizëm, të cilin Komisioni Evropian e ka pranuar si zgjidhje politike, nuk mund të pranohet dhe nuk duhet të legjitimohet në vitin 2023", thotë Miftaraj. Ai shton se Administrata Koordinuese për dhënie e pasaportave për qytetarët që jetojnë në Kosovë ekziston për shkak se BE-ja nuk e ka detyruar Serbinë që ta njohë Kosovën dhe të ofrojë një zgjidhje praktike pa

e shkelur Kushtetutën e Kosovës. Në vitin 2009 Serbia ka formuar Administratën Koordinuese si organ të Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme për lëshimin e pasaportave për qytetarët me vendbanim në Kosovë. Ky, në fakt, ka qenë kusht i BE-së që Serbia ta merrte liberalizimin e vizave, me shpjegimin se, në të kundërtën, ka rreziqe sigurie që kanë të bëjnë veçanërisht me migracionin ilegal.

Deri atëherë pasaportat serbe lëshoheshin nga drejtoritë policore për qytetet e Kosovës, si ajo në Prishtinë, Ferizaj, Pejë e kështu me radhë. Këto administrata policore nuk përmenden në pasaportat e Administratës Koordinuese, por vetëm thuhet se dokumenti është lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë.

## Policia dhe KFOR-i merren vesh për vazhdimin e bashkëpunimit në shtimin e sigurisë

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, ka pritur të mërkurën në takim njohës komandantin e KFOR-it, gjeneralin Ozkan Ulutas, me të cilin ka diskutuar për tema të ndryshme në interes të situatës së sigurisë në vendin tonë.

Në takim u rikonfirmua vazhdimi i bashkëpunimit të mëtejshëm dhe avancimit të shkëmbimit të informacioneve në funksion të ruajtjes së një ambienti më të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim. Temë tjetër e diskutimeve ishin aktivitetet dhe patrullimet e përbashkëta në

mes të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, të cilat reflektojnë në situatën e sigurisë në tërë vendin, përfshirë veriun. Të dy palët u pajtuan se vazhdimi i bashkëpunimit, mirëbesimit dhe realizimit të aktiviteteve të përbashkëta, ndikon në rritjen e mëtejme të nivelit të sigurisë së përgjithshme.



## Aktakuzë kundër një serbi të dyshuari për masakrën në burgun e Dubravës

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Prokuroria Speciale (PS) e Kosovës ka njoftuar të mërkurën se ka ngritur aktakuzë kundër një të pandehuri të nacionalitet serb nën dyshimin se ai kishte marrë pjesë “në vrasjen e mbi 100 shqiptarëve në burgun e Dubravës në vitin 1999”.

I dyshuari me inicialet G. M., i cili ka dyshetësi, kosovare dhe serbe, por me adresë vendbanimi në Serbi, sipas Prokurorisë, ngarkohet me veprën penale “krimi i luftës kundër popullsisë civile”.

Prokuroria tha se i dyshuar ndodhet në paraburgim “deri në një vendim të ri nga ana e gjykatës”.

Ai akuzohet se “më 22 maj 1999 mori pjesë në vrasjen e njëqind e nëntë (109) të burgosurve dhe në plagosjen e njëqind e tetë (108) të burgosurve të tjerë, që të gjithë të nacionalitetit shqiptar, e njohur si ‘Masakra e Dubravës’”.

Prokuroria tha se ka gjetur prova të mjaftueshme juridike “që



dëshmojnë se i pandehuri në bashkëkryerje me persona të tjerë të forcave policore dhe

ushtarake serbe ka marrë pjesë dhe ka kontribuar” në kryerjen veprës penale për të cilën

akuzohet. Hetimet ndaj të pandehurve të tjerë janë duke vazhduar në

mungesë, pasi janë të paarrtshëm për organet e rendit, thuhet në njoftim.

Para 24 vjetëve brenda burgut të Dubravës u vranë 160 të burgosur shqiptarë dhe u plagosën më shumë se 300 të tjerë. Kjo masakër zgjati disa ditë, përkatësisht nga 19 deri më 24 maj 1999.

Masakra në Burgun e Dubravës është cilësuar edhe më herët nga përfaqësuesit politikë në Kosovë si një nga krimet më monstruoze për të cilin ende askush nuk është gjykuar.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur.

Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe njihet nga mbi 100 vende të botës.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e saj dhe në Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë atë si pjesë të territorit të saj.

## KQZ-ja publikon raportet financiare të partive politike për vitin 2022



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar në uebfaqe raportet vjetore financiare pas përfundimit të procesit të auditimit nga auditorë të cilët janë përzgjedhur nëpërmjet një konkursi të hapur publik nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP). Me këtë publikim, KQZ-ja ka përmbyllur procesin e publikimit të raporteve vjetore financiare të partive politike për vitet 2021 dhe 2022 si dhe të raporteve financiare të deklarimit financiar të fushatës së

zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës (14 shkurt 2021) dhe zgjedhjeve lokale për Kuvende Komunale dhe dy raundet për kryetarë të komunave (17 tetor 2021 dhe 5 nëntor 2021).

Më 13 nëntor KQZ-ja ka publikuar raportet e audituara financiare të vitit 2021, të cilat u takojnë partive politike dhe raportet e audituara të deklarimit financiar të fushatës së proceseve zgjedhore që janë mbajtur gjatë vitit 2021. Duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, të gjitha partitë politike të regjistruara janë të obliguara që deri më 1 mars të çdo viti t'i

dorëzojnë raportet vjetore financiare, ndërsa pas çdo palë zgjedhjeve subjektet politike garuese duhet ta dorëzojnë raportin financiar të fushatës më së largu deri 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve.

Me qëllim të rritjes së transparencës, prej disa vitesh KQZ-ja ka publikuar raportet vjetore financiare dhe raportet e fushatave zgjedhore edhe kur ato nuk kanë qenë të audituara, duke sqaruar se të njëjtat mund të pësojnë ndryshime dhe saktësime gjatë procesit të auditimit.

## Kurti pret në takim ambasadorin gjerman, temë diskutimi zhvillimet e fundit në vend

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Takimin e parë të ditës së mërkurë në zyrën e tij, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e zhvilloi me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde.

Folën për marrëdhëniet bilaterale dhe bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe

Gjermanisë, temat aktuale dhe zhvillimet e fundit në vend.

Gjatë këtij takimi, kryeministri Kurti pranoi nga ambasadori gjerman Rohde një kopje të librit “Gjermania dhe Kosova: historia e një partneriteti” nga autorët Enrico Seewald dhe Urs Unkauf, që përshkruan dhe

shtjellon historikun e raporteve të shkëlqyeshme ndërmjet dy shteteve dhe popujve.

Krahas falënderimit për librin, kryeministri e falënderoi ambasadorin Rohde për bashkëpunimin e afërt, dhe shtetin gjerman për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës.



Reagim i KMDLNj-së

## Pse nuk duhet të votohet traktati për burgje me Danimarkën?

1. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kanë qenë drejt të informuar për përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje.

2. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë informuar as për veprat që janë dënuar këta të burgosur e as për shtetin nga e kanë prejardhjen.

3. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë informuar se asnjë i burgosur nuk është danez apo shtetas danez.

4. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë informuar se këta të burgosur do të transferohen dhunshëm dhe kundër vullnetit të tyre në Kosovë.

5. Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta kenë të qartë se këta të burgosur janë kryesisht nga shtetet afrikane, aziatike dhe arabe dhe të besimit islam.

6. Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta kenë të qartë se këta nuk transferohen në Kosovë shkak të Kosovës i trajton mirë (edhe i trajton mirë sipas standardeve kosovare të dënuarit kosovarë) për faktin se përgjegjësinë për trajtimin e tyre e ka shteti danez por se ata dërgohen në Kosovë sepse Kosovën e konsiderojnë si një shtet islamik i afërt me përcaktimin fetar të burgosurve që do të kontrabandohen nga Danimarka në Kosovë.



7. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë informuar se si do të organizohen vizitat familjare të cilat janë më të shpeshta se në Kosovë. Paramendojeni situatën kur 300 të burgosur në të njëjtën kohë vizitohen nga 1200 familjarë! Do të krijohet një situatë sikur të ishin në Afganistan, Sudan, Siri apo Pakistan. Kufizimi i vizitave do të ishte shkelje e të drejtave të njeriut.

8. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë informuar se kjo çështje ndërlidhet drejtpërdrejtë me sigurinë dhe rrezikon sovranitetin e vendit nga rrymat radikale politike dhe fetare.

9. Deputetët e Kosovës nuk janë

informuar si do t'i realizojnë të burgosurit e kontrabanduar nga Danimarka beneficinet që iu takojnë sipas ligjit si vikendet jashtë burgut, pushimet vjetore, realizimi i vizitave humanitare etj.

10. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë informuar se si do të trajtohen në aspektin shëndetësor rastet kur është e nevojshme trajtimi jashtë objektit të burghotelit në Gjilan. Kush do të garantojë për sigurinë e tyre?

11. Deputetët nuk janë informuar se si do të komunikojnë të burgosurit me stafin korrektues (janë kosovarë), si do të informohen në gjuhën e tyre amtare apo në gjuhën që e

kuptojnë dhe se kush do të përkujdeset për realizimin e të drejtave fetare që iu takojnë. Mos do të jetë BIK-u, vallë?

12. Deputetët duhet të informohen se me këtë traktat kriminal dhe racist po legalizohet sistemi paralel korrektues dhe në Kosovë do të kemi tre sisteme korrektuese; ai i Kosovës që zbatohet aktualisht, ai i Zajebnicës kur të fitohet autonomia për serbë dhe ai për të burgosurit që do të kontrabandohen nga Danimarka.

13. Deputetët duhet të informohen se me këtë traktat kriminal dhe racist po përligjet ndarja e Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe po përligjet diskriminimi i të burgosurve që vuajnë dënimin në të njëjtin vend në Kosovë.

14. Deputetët duhet të informohen se përfitimi material prej afërsisht 15 milionë euro brenda viti është i papërfillshëm krahasuar me dëmet afatgjate që i shkaktojnë Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës.

15. Deputetët duhet të informohen se me këtë përligje të diskriminimit do të krijohen kushte reale dhe të arsyeshme për rebelim të burgosurve kosovarë që janë nën përkujdesje të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

KMDLNJ, që nga dita e parë e ka

kundërshtuar këtë marrëveshje dhe në këtë drejtim ka bashkëpunuar me organizatat dhe individë nga Danimarka që e kundërshtojnë këtë marrëveshje të burgosur i kontrabandon në Kosovë në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut dhe miratimi eventual nga Kosova i kësaj marrëveshje e vë Kosovën në bankën e të akuzuarve për shkelje të drejtave të njeriut. Para se të hedhet në votim është dashur të kërkohet mendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nëse është në përputhje me të drejtat e njeriut. Sponsorizuesi i këtij traktati është i udhëhequr nga interesi politik dhe as që i intereson për dëmet që ia bën Kosovës. Tërë kohën e ka mashtruar edhe opinionin si dhe deputetët prandaj ka heshtje dhe mosreagim të opinionit.

Prandaj, deputetë të Kuvendit të Kosovës, mos e votoni këtë traktat të dëmshëm, racist dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Refuzoni të votoni traktat kundër interesave të Kosovës sepse, po të ishte diçka e mirë, as që do t'i vinte rendi Kosovës për këtë. Kosovën duan ta shndërrojnë në deponi për mbetje njerëzore të njerëzve të pafat dhe mos u bëni pjesë e këtij krimi.

## 11 vjet pas triumfit në Gjykatën e Hagës, Haradinaj: Do të vërtetohen pastërtia dhe pafajësia e bashkëluftëtarëve që po përballen me drejtësinë

PRISHINË, 29 NËNTOR - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kujtuar të mërkurën procesin gjyqësor ndaj tij në Tribunalin e Hagës, i cili kishte zgjatur me vite të tëra për të përfunduar në favor të tij dhe bashkëluftëtarëve të tij. "Më 17 nëntor 2004 pata marrë ftesë për t'u paraqitur për intervistim para prokurorëve të Hagës në Prishtinë, si i dyshuar për krime lufte dhe thyerjen e ligjeve dhe rregullave të luftës, ndërkaq më 8 mars 2005 dhashë dorëheqje si Kryeministër i Kosovës. Pas marrjes së aktakuzës së parë, filloi një proces i gjatë gjyqësor. Që nga ajo ditë e deri më 29 nëntor 2012, zgjati ndjekja ligjore ndaj meje. Edhe pse në aktgjykimin e parë u lirova si i pafajshëm, gjatë shqyrtimit në shkallën e dytë u vendos për rigjykim. I gjithë ky proces gjyqësor zgjati më shumë se 8 vjet, ku përfundimisht sot para 11 vjetësh, mora aktvendimin e pafajësisë i cili vulosi pafajësinë time dhe të bashkëluftëtarëve të mi, për luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK-së", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka thënë se në këtë proces për vendosjen e drejtësisë asnjëherë nuk ka mbetur i vetëm. "Kisha afër familjen, bashkëluftëtarët, gjithë qytetarët e diasporën, por edhe institucionet tona, edhe pse në pjesën e parë nuk ishim shtet i



pavarur. Edhe atë kohë kishim ndjenjën që drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, por megjithatë

kur erdhi ishte lehtësim i madh, çlirim nga padrejtësitë që ndodhën gjatë procesit. Po ashtu sot besoj që

do të vërtetohet pafajësia dhe pastërtia e bashkëluftëtarëve që janë duke u përballë me sfidën e radhës

në Hagë. Ata shkuan si çlirimtarë atje, ashtu do të kthehen!", ka theksuar Haradinaj.

## Asetet e Fondit Pensional zvogëlohen për 305 milionë euro

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Asetet e fondeve pensionale kanë shënuar rënie të madhe në muajin tetor krahasuar me një muaj më herët. Kontributdhënësve të fondit pensional u janë "tkurrur" asetet për 305 milionë euro nga investimet e letrave me vlerë. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), struktura e asteve të

fondit pensional nga investimet e letrave me vlerë deri në muajin tetor ishte rreth 1.66 miliard euro, duke shënuar rënie për 305 milionë eurosh krahasuar me muajin paraprak. "Struktura e aseteve të sektorit pensional dominohet nga letrat me vlerë të kapitalit që përbejnë 64 për qind të gjithsej aseteve", është thënë në raportin e BQK-së.

Asetet e fondeve pensionale kanë shënuar rënie edhe në tërësinë e tyre. "Në fund të muajit tetor 2023 janë zvogëluar për 21.5 milionë euro krahasuar me muajin paraprak duke shënuar vlerën 2.60 miliardë euro", është thënë në këtë raport. E gjithë kjo rënie vjen si pasojë e luhatjes së çmimeve në tregjet globale.



## Paratë e falsifikuara, ish-guvernatori i BQK-së: Qytetarët duhet t'i shmangin pagesat me 'cash'

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ka bërë me dije të mërkurën se ka arrestuar gjashtë persona, prej të cilëve tre shtetas nga Kosova dhe tre nga Maqedonia e Veriut, të cilët dyshohen për falsifikim të parasë. Në këtë operacion, sipas prokurorisë, janë sekuestruar mbi 85 mijë euro në monedha dyeshe të cilat dyshohen se janë të falsifikuara.

Ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka bërë thirrje për kujdes nga monedhat dhe kartëmonedhat e falsifikuara. Sipas tij, të dhënat e fundit tregojnë se ka vazhduar rritja e monedhave-kartëmonedhave në qarkullim që janë të falsifikuara. "Ndonëse nuk mund të ketë dhëna të sakta se sa para të tilla janë në qarkullim, në këtë rast tregtarët, qytetarët janë në kontakt të vazhdueshëm me paratë, i kanë jo të panjohura përvojat me paratë e falsifikuara. Mund të themi që ka tentativa, sidomos në Kosovë, që është një ekonomi që qarkullon me vlera të larta në kesh, për ndryshim me shtetet e tjera, ku janë të zhvilluara edhe metoda alternative të tjera dhe para fizike ka ardhur në rënie si vlerë. Tentativat për para të falsifikuara mund të jenë të shpeshta, por masat që merren duhen të jenë të shpejta", ka thënë Mehmeti.

Ai ka thënë se përgjithësisht klientët nuk janë në dijeni, që janë duke futur një monedhë-kartëmonedhë të falsifikuar në bankë. Sipas Mehmetit, sektori



bankar në Kosovë përdor identifikimin e kamerave apo me aparatet e numërimit të cash-it që, përveç numërimit, bëjnë dhe identifikimin e elementëve të sigurisë. "Në këto raste thirrja ime për qytetarët është që duhet të shmangin pagesat me 'cash', pasi mundësitë për të rënë në kontakt me monedhë-kartëmonedhë të falsifikuara janë më të mëdha. Çdo biznes, por edhe qytetari do të duhet të jetë i kujdesshëm në qarkullimin e kartëmonedhave. Veprimet

financiare me monedha-kartëmonedha duhet t'i bëjnë nëpërmjet bankave për të evituar keqkuptimet, për të evituar mundësinë që dikush në një moment të caktuar t'i pasojë një monedhë-kartëmonedhë të dyshuar si të falsifikuar", ka shkruar Mehmeti në "Facebook". Ai ka theksuar se trajnimet mbi elementët e sigurisë së monedhave-kartëmonedhave do të ishin të domosdoshme të mbahen nga institucione të specializuara. "Në këtë rast edhe

vet institucionet që kanë qarkullime të mëdha të parave 'cash' duhet të investojnë në trajnime të stafëve të tyre mbi elementët e sigurisë së monedhave-kartëmonedha, dhe njëkohësisht kushdo që qarkullon apo ka lidhje me përpunimin e 'cash'-it të pajiset me të njëjtat makineri dhe të përditësohet çdo vit, në këtë rast kjo mund të ju duket si kosto, por kjo do të mbajë larg këta persona që duan të kanalizojnë monedha-kartëmonedha false", ka thënë ai.

Mehmeti ka thënë se Banka Qendrore e Kosovës duhet ta vazhdojë marrjen e masave për mbrojtjen nga falsifikimi. "Në këtë rast edukimi financiar duhet që nëpërmjet trajnimeve, kualifikimeve dhe pjesëmarrjes në seminare dhe workshop-e, të bëjë vetëdijësimin e qytetarëve, për t'i informuar, orientuar dhe trajnuar ata, lidhur me elementet e sigurisë të kartëmonedhave, si dhe të faktorëve që sjellin minimizimin e falsifikimit të tyre", ka theksuar Mehmeti.

## Peci: 4.6 milionë euro është përkrahja financiare për fermerët që kanë mbi pesë krerë lopë

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka thënë se përkrahja për përpunuesit e qumështit është rritur. Vetëm gjatë vitit 2023 përmes programit për pagesa direkte, Peci ka deklaruar se shifra e përkrahjes financiare për fermerët që kanë mbi pesë krerë lopë është rreth 4.6 milionë euro.

Në konferencën e organizuar nga Shoqata e Prodhuesve të

Qumështit të Kosovës (ShPQK), Peci është shprehur se këtë vit në Kosovë janë rreth 5 200 fermerë me mbi pesë lopë qumështore si dhe 1 355 fermerë të bagëtitve të imta me mbi 30 krerë.

Ministri Peci ka përmendur një fermer që së fundmi e ka vizituar e që, sipas tij, falë përkrahjes nga qeveria, ka arritur t'i zgjerojë kapacitetet prodhuese. Ai ka thënë se deri në pesë mijë litra qumësht është kapaciteti i pranimit

ditor që e prodhon ky fermer. "Në bazë të të dhënave dhe statistikave, Kosova në vitin 2023 ka rreth 5 200 fermerë me mbi pesë lopë qumështore si dhe 1 355 fermerë të bagëtitve të imta me mbi 30 krerë. Përmes programit për pagesa direkte 2023, rreth 4.6 milionë euro është shifra e përkrahjes financiare për fermerët që kanë mbi 5 krerë lopë, me një shifër të përafërt rreth 52 mijë gjithsej", ka thënë Peci.





# Gjykata Speciale e Kosovës, teatër pa publik



Nga: Bekim ÇOLLAKU

Gjykata Speciale e Kosovës, e vendosur në Hagë, është një institucion që vazhdon të prodhojë drama, por edhe komedi për vëmendjen e opinionit publik të Kosovës dhe atij ndërkombëtar.

Kjo gjykatë u themelua si rezultat i presioneve dhe imponimeve të hekurta të faktorit ndërkombëtar, si një mekanizëm i besueshëm për të trajtuar akuzat për trafikim me organe njerëzore, të përmbledhura në raportin të Dick Marty, që u miratua nga Këshilli i Evropës. Të mos harrojmë faktin se ishte Rusia ajo e cila në koordinim me Serbinë arritën të krijojnë rrethana për të alarmuar fillimisht faktorin ndërkombëtar, e më vonë edhe për t'i bindur ata, se pretendimet e tyre për të akuzuar ish-udhëheqësit e UÇK-së për përfshirje në trafikim me organe njerëzore kinse ishin të bazuara në "fakte". Çuditërisht, faktori ndërkombëtar ra në këtë grackë, dhe me lehtësi vendosi të ndëshkojë Kosovën e vogël, duke e ngarkuar me këtë barrë sa të padrejtë aq edhe të rëndë.

I gjithë procesi, që nga zanafilla e deri më sot, është misterioz,

kontrovers, i motivuar etnikisht dhe tërësisht politik. Dhomat e Specializuara u themeluan për të trajtuar akuzat që implikonin ish-udhëheqësit e UÇK-së në krimet e pretenduara për trafikim me organe njerëzore. Megjithatë, aktakuzat e ngritura në mënyrë spektakulare në vitin 2020, përfshinin gjithçka përveç akuzës për trafikim me organe njerëzore - shkaku kryesor të themelimit të saj. Prandaj, ky zhvillim ngriti pyetje mbi motivin dhe ndikimet politike të faktorit ndërkombëtar në fushën e drejtësisë dhe procesit në tërësi. Në fakt, ngritja e aktakuzës së tillë, është dëshmia e dhimbshme e mashtrimit që iu është bërë institucioneve shtetërore të Kosovës dhe lidërshipt shtetëror të asaj periudhe.

Ky mashtrim ka qenë i pashmangshëm në rrethanat e asaj periudhe të shtet-ndërtimit, aq më tepër, në periudhën kur udhëheqësit shtetërorë të Kosovës kishin besim absolut tek partnerët tanë ndërkombëtar, e sidomos tek ShBA-atë. Në fakt, tingëllon paradoksale, mirëpo ata që mbahen të paraburgosur në Hagë, ende vazhdojnë të

besojnë tek drejtësia ndërkombëtare dhe tek vlerat civilizuese perëndimore të ShBA-së dhe BE-së.

Dhomat e Specializuar aktualisht janë duke operuar brenda një konteksti të ndjeshëm politik, në përpjekje gjoja për të vënë drejtësinë. Drejtësia është e vetmja kërkesë edhe e atyre që po mbahen në burg për më shumë se tri vite. Është për keqardhje fakti që procesi maratonik i gjykitimit po shoqërohet me dobësi dhe mungesë të transparencës. Pjesa më e madhe e dëshmitarëve të prokurorisë janë anonimë dhe të mbrojtur, duke krijuar një atmosferë të mbyllur dhe të pakontrollueshme për publikun. Kjo mungesë transparence, ngre shqetësime serioze mbi legjitimitetin dhe drejtësinë e verdikteve që pritet të shpallen në fund të këtij procesi.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që ka nxjerrë në pah ky proces, është trajtimi i të paraburgosurve. Në fakt, masat e fundit, si ndalimi i takimeve me familjarët dhe ndërprerja e komunikimeve të tjera, paraqesin shkelje të drejtave të njeriut, të garantuara nga

kushtetuta dhe konventat ndërkombëtare. Preteksti për marrjen e këtyre masave kufizuese ndërlidhet me takimet dhe përmbajtjen e bisedave të monitoruara ndërmjet të paraburgosurve dhe bashkëpunëtorëve e miqve të shumtë që i kanë vizituar ata. Lidhur me këtë gjë, duke respektuar kodin e sjelljes, mund të them vetëm një gjë, se është e pamundur që brenda atij burgu të diskutohet vetëm për problemet klimatike dhe ngrohjen globale.

Në një botë ku drejtësia ndërkombëtare shpesh duket si një lojë shahu politik, Gjykata Speciale e Kosovës ka vendosur të luajë një rol protagonist. Themeluar nën pretekstin e zbardhjes së akuzave për trafikim me organe njerëzore, bazuar në narrativë strategjike, përkundër të vërtetës se faktet dhe koha demantoi gjithçka, kjo gjykatë ka evoluar në një spektakël gjyqësor, që ka të gjitha elementet e një drame me intrigë dhe dyshime. Si një maratonë e gjatë ku askush nuk e di vijën e finishit, procesi gjyqësor mbetet një spektakël i vazhdueshëm i mungesës së

transparencës, llogaridhënies dhe drejtësisë. Me dëshmitarë të mbrojtur dhe anonimë, seanca të mbyllura për publikun – gjithçka tingëllon si një recetë për një dramë të vërtetë, ku askush nuk mund të pretendojë se ka parë të vërtetën. Në këtë teatër absurd, të drejtat e njeriut janë si personazhet anësore që shpesh harrohen.

Masat e fundit ndëshkuese ndaj të paraburgosurve, si ndalimi i takimeve me familjarët, janë shkelje në skenë, por që audiencën e shtynë të pyesë: "A është ky një proces gjyqësor apo një lojë kontrolli?" Një pyetje retorike, sigurisht, në një botë ku drejtësia ndonjëherë duket më shumë si një iluzion.

Në fund të ditës, Gjykata Speciale e Kosovës duket më shumë si një shfaqje e gjatë me shumë pauza, ku drejtësia është më shumë një figurant se sa një protagonist. Një ironi tragjike, ku drejtësia ndërkombëtare shndërrohet në një skenë politike, ku aktorët luajnë sipas një skenari të shkruar nga forca të padukshme. A do të dalë ndonjëherë drejtësia në skenë? Publiku i neglizhuar mbetet në pritje, por, siç flasin shenjat, me pak shpresë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Walid Hamidi, 'Ylli i javës' në Superligë

**SUHAREKË, 29 NËNTOR** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i Javës". Ky çmim për javën e 15-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të Ballkanit, Walid Hamid, raporton FFK-ja. Vlerësimi i më të mirit të

javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Sunaj Keçi, Blerim Haxholli dhe Besim Slishani. Ky komision vlerësoi që Walid me depërtime e tij të rrezikshme e vuri në vështirësi ekipin vendas dhe me asistimet e tij e vulosi ndeshjen Malisheva -

Ballkani. Pasi mori këtë çmim Walid u shpreh i lumtur për fitoren dhe për vlerësimin si më i miri i xhiros. "Jam shumë i lumtur për këtë trofe, ku u zgjodha lojtari i javës. Kam mësuar shumë nga trajneri dhe nga bashkëlojtarët e mi të mirë. Falënderoj të gjithë grupin tonë! Këtë fitore e arritëm së

bashku. Shpresojmë të jemi përsëri kampionë sepse e meritojmë. Ndeshja shkoi mirë. Sidomos në pjesën e parë luajtëm shumë mirë dhe arritëm të shënonim 2 gola. Po ashtu, edhe pjesa e dytë ishte një shfaqje e mirë e lojës. Çdo ndeshje është e rëndësishme për ne. Jemi të përqendruar në çdo lojë dhe



pse jo, të jemi përsëri kampionë", ka deklaruar Walid Hamid për faqen zyrtare të FFK-së.

## Ballkani sonte në 'Air Albania' përballet me Viktoria Plzen

Klubi i Ballkanit do të përballet me Viktoria Plzen në stadiumin "Air Albania". Synim i kampionëve të Kosovës në këtë ndeshje është paraqitja sa më dinjitoze dhe marrja e rezultatit më të mirë të mundshëm. Trajneri Ilir Daja e ka pranuar se klubi çek ka përvojë më të madhe dhe është favorit në këtë ndeshje



riparimin e saj. Strategu Ilir Daja e ka pranuar se skuadra kundërshtarë ka eksperiencë me të madhe se Ballkani dhe se është favorit në këtë ndeshje. Megjithatë ai ka premtuar angazhimin maksimal për të nxjerrë më të mirën nga kjo sfidë. "Përveç që kryeson grupin, Viktoria Plzen ka përvojë në kompeticione tjera madhore të UEFA-s. Nuk jemi të barabartë. Është ekip që ka eksperiencë më të madhe sesa ne. Nuk e dimë se çfarë do të ndodh nesër. Ne do të japim

maksimumin. Natyrshëm nëse duhet bërë llogaritë se si do dalin ndeshjet paralele. Fillimisht të shohim ndeshjen tonë. Do të bëjmë të pamundurën. Vështirësia është e madhe", ka thënë Daja. Në konferencën për medie i

pranishëm ishte edhe mbrojtësi Bajram Jashanica, i cili lidhur me ndeshjen ndaj Viktoria Plzen: "Është ndjenjë e jashtëzakonshme të paraqitesh në këto nivele. Shpresojmë të vazhdojmë sa më gjatë me Ballkanin në Ligën e

Konferencës. Jemi ende në garë. Të marrim ndeshjet një pas një. Na duhet të përqendrohemi dhe të japim maksimumin secili nga ne që do të paraqitemi në fushë. Tani nuk kemi presion. E kemi arritur limitin si ekip kosovar. Tani jemi në rrugë të mirë. Nuk do të futemi me presion. Do të jetë një ndeshje e mirë për ne". "Përderisa jemi në këto niveli. Pse mos të provojmë edhe në grupet e Ligës së Kampionëve. Por, ajo arrihet me punë dhe disiplinë. Pse mos të vazhdojmë ëndrrën tonë", ka shtuar Jashanica. Skuadra e Ballkanit renditet në vendin e tretë në Grupin C me katër pikë. Në vendin e parë renditet Viktoria Plzen me 12 pikë dhe tashme e ka siguruar kalimin e tutje. Në vendin e dytë është Astana me pikë të barabarta me Ballkanin, kurse Dinamo Zagrebi renditet në vendin e fundit me tri pikë.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 29 NËNTOR** - Kampionia e Kosovës në futboll, Ballkani e zhvillon ndeshjen e radhës në Ligën e Konferencës. Skuadra e drejtuar nga Ilir Daja e pret Viktoria Plzen në stadiumin "Air Albania" në Tiranë nga ora 18:45. Kjo ndeshje zhvillohet në kryeqytetin shqiptar përshkak se gjendja e stadiumit "Fadil Vokrri" nuk është në gjendje të mirë dhe po intervenohet në

## Zyberaj: Vrapova për shpirtin e babait. Ma la amanet

Tiranë, 29 nëntor - Me rastin e festës së 28 Nëntorit, atleti nga Kosova, Erzen Zyberaj, ka vrapuar në një distancë prej 260 kilometrash, nga Prishtina në Tiranë. Zyberaj ka thënë se këtë aktivitet e ka bërë për nder të babait të tij i cili ia ka lënë amanet. Ai ka deklaruar se është rritur gjithmonë me frymën e patriotizmit dhe dashurinë e atdheut. Atleti nga Kosova shtoi se e ka ëndërr që Kosova e Shqipëria të bashkohen. "Kam vrapuar për të gjithë ata shpirtra të njerëzve që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë për Shqipërinë. Unë kam vrapuar për shpirtin e tij. Rruga



më shkoi 28 orë. Ka pasur komente të ndryshme dhe pozitive. Babi im dhe ne

gjithmonë jemi rritur me frymën patriotike. Kemi shikuar gjithmonë filma shqip. Tri orë

kam dëgjuar kolonën zanore të 'Udhës së Shkronjave'. Ëndrra për të qenë një do të jetë deri në frymën e fundit. Ai njeri që e ndien veten shqiptar duhet ta ketë të ngulitur", ka thënë Zyberaj në një intervistë për "Euronews Albania". 28 nëntori shënon ngjarje të mëdha në historinë e shqiptarëve. Përpos Ditës së Flamurit, shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, shënon edhe lindjen e komandantit legjendar Adem Jashari dhe daljen publike të UÇK-së. Shqiptari nga Kosova për emisionin "Good Morning Albanians" në "Euronews Albania" ka shtuar se nuk ka

pasur mbështetje nga Kosova duke shtuar se në maratona ka dëshirë ta përfaqësojë Shqipërinë. Mes të tjerash, ai nënvizoi se s'ka pasur mbështetje nga askush, duke shpresuar që në të ardhmen të ndryshojnë gjërat. "Unë mendoj ta përfaqësoj shtetin shqiptar në këto gara. Shteti nuk ka pasur leverdi të më mbështesë. Domethënë i është dukur absurde. Unë ndihem krenar ta përfaqësoj Kosovën, por ama ndihem i pavlerësuar. S'kam përkrahje nga askush. Shpresoj që në të ardhmen të ndryshojnë gjërat jo vetëm për mua, po për të gjithë", ka deklaruar Zyberaj.

## Mirsad Jonuz emërohet trajner i Lirisë

Prizren, 29 nëntor - FC Liria e ka emëruar Mirsad Jonuz në pozitën e trajnerit. Jonuz ka qenë ish-përzgjedhës i Maqedonisë së Veriut dhe ka firmosur kontratë deri në fund të edicionit, ku misioni i tij do të

jetë mbijetesë. Jonuz është njëri prej trajnerëve më të vlerësuar në Maqedoninë e Veriut, ndërsa Liria këtë edicion është rikthyer në elitën e futbollit kosovar dhe zë vendin e fundit në tabelë me tetë pikë të mbledhura pas 15

xhirove të zhvilluara. Jonuz ka punuar në shumë skuadra, sidomos në Maqedoninë e Veriut, ku ka drejtuar Rabotniçkin e Pobeđen. Ka punuar edhe në Qipro e Greqi, te skuadrat Nea Salamis

Famagusta e Aiginiakos. Ka qenë edhe trajner i Vllaznisë së Shkodrës, ndërsa së fundmi, ka qenë në Katar te skuadra e Lusailit. Jonuz prej vitit 2009 deri në vitin 2011 ka qenë selektor i Maqedonisë së Veriut, ndërsa



më herët ka drejtuar edhe ekipin U21 për gjashtë vjet.

## Milani ka vetëm një shans për t'u kualifikuar në Ligën e Kampionëve, rrezikon dhe Ligën e Evropës

MILANO, 29 NËNTOR - Milani pësoi humbje ndaj Borussia Dortmundit (1-3) dhe tashmë e sheh veten me një këmbë jashtë Ligës së Kampionëve. Me vetëm një ndeshje të mbetur, grupi kryesohet nga Borussia Dortmundi me 10 pikë, që ka siguruar edhe kualifikimin, i

ndjekur nga PSG-ja me 7 pikë dhe Newcastle e Milani me nga 5 pikë. Dy të fundit do të përballen me njëra-tjetrën në ndeshjen e fundit më 13 dhjetor në Angli, megjithatë fitorja mund të mos u shërbejë kuqezinjve për t'u kualifikuar. PSG-së i mjafton një pikë në

transferten ndaj Dortmundit për t'u kualifikuar matematikisht, në rast fitoreje të Milanit në Angli. Nga ana tjetër, fitorja e mundshme e Newcastle's kërcënon jo pak PSG-në, që do të jetë e dënur të triumfojë në "Signal Iduna Park" për t'u kualifikuar.

Kuqezinjtë e Piolit nuk e kanë më fatin në dorën e tyre, por do të shkojnë në Angli për të fituar, që të sigurojnë minimalisht pjesëmarrjen në Ligën e Evropës. Kjo pasi edhe me barazim në Angli, në Ligën e Evropës shkon Newcastle, që ka golavarazh më të mirë.



## Sylvinho: Pas Evropianit dua ta dërgoj Shqipërinë edhe në Botërorin 2026

TIRANË, 29 NËNTOR - Një ndër intervistat e shumta të këtyre ditëve nga Sylvinho pas kualifikimit në Evropian është edhe ajo që ka dhënë përfaqen "cronachedispogliatoio". Trajneri shprehet se objektivi i tij është ta dërgojë Shqipërinë në Botëror pas "Euro 2024", si dhe zbulon urimin e Roberto Mançinit pas suksesit që braziliani arriti. "Në vëshëllimin e fundit të gjyqtarit kundër Moldavisë shpërtheva. Kam nxjerrë jashtë gjithë ankthin dhe gëzimin e 10 muajve punë. Kam vrapuar për të festuar me njerëzit kualifikimin për në Evropian", thotë fillimisht Sylvinho. I pyetur se kur kishte dëgjuar për herë të parë për Shqipërinë, trajneri thotë se nga Rei Manaj: "E dija ekzistencën e Shqipërisë vetëm përmes Rei Manajt që e kam trajnuar tek Interi. Nuk dija asgjë më shumë. Më pas kam mbërritur aty dhe kam parë që të gjithë njerëzit flasin italisht, e njohin, flasin anglisht, spanjisht. Është e rëndësishme që një trajner të flasë pa një përkthyes", ishin fjalët e Sylvinhos.

Trajneri 49-vjeçar shprehet se ka një ngjashmëri mes shqiptarëve dhe brazilianëve dhe kjo është vënë re nga vetë ai: "Shqiptarët janë njerëz të ngrohtë dhe mikpritës, si ne brazilianët. Më kanë bërë që të ndihem si në shtëpi, që në fillim kur kam ardhur: më kanë ofruar kafe dhe



darkë kudo", shprehet trajneri i Shqipërisë. Shqipëria mori një barazim tepër të rëndësishëm në Pragë, ku goli i Bajramit ishte si një pikë kthese për këtë kualifikim. Atmosfera në stadium, sipas Sylvinhos, ishte jashtëzakonshme, kur shumë shqiptarë e bënë atë të ndihej sikur luante në shtëpi: "Kemi pasur një mbështetje të jashtëzakonshme në Pragë, kundër Republikës Çeke. Më dukej dikur luaja në shtëpi. Ishte plot me shqiptarë", tregon Sylvinho për ndjesitë e asaj transferte. Trajneri brazilian zbulon urimin që ka marrë pas suksesit: "Pas kualifikimit më ka shkruar

Mançini dhe më ka dërguar komplimentet e tij. Më ka trajnuar dhe më pas kam qenë ndihmës i tij tek Interi. Është një fitues, Inter, Siti dhe te Kombëtarja. Kudo që ka drejtuar e ka çuar skuadrën në një nivel shumë të lartë", ka deklaruar ai. "Shqipërisë nuk duhet t'i mjaftojë kualifikimi. Nuk duhet të shkojë në Evropian dhe pastaj të zhduket. Dua të krijoj një mentalitet që në çdo Evropian dhe Botëror, Shqipëria të kualifikohet. Ky është objektivi im pas Evropianit. Dua ta dërgoj Shqipërinë në Botërorin e 2026-s. Ky duhet të jetë vetëm fillimi", ka përfunduar trajneri i kuqezinjve.

## Bostoni e Milwaukee komandojnë në Lindje

Boston, 29 nëntor - Bostoni nuk lëshon kreun në Konferencën e Lindjes, duke fituar me rezultat 124-97 ndaj Chicagos, në një ndeshje të dominuar nga Celticsi. Për vendasit të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Browni me 30 pikë. Milwaukee mposhti Miami (131-124), një përballje mes dy ekipesh rivale. Antetokounmpo me 33 pikë e Lillardit me 32 bënë dallimin në fushë për Bucksin, duke i bërë të



pavlefshme 31 pikët e Adebayo për ekipin nga Florida. Humbje në sekondat e fundit për Golden

### REZULTATET

Boston - Chicago	124-97
Brooklyn - Toronto	115-103
Cleveland - Atlanta	128-105
Miami - Milwaukee	124-131
New York - Charlotte	115-91
Minnesota - Oklahoma	106-103
Dallas - Houston	121-115
Sacramento - Golden S.	124-123

Staten, që u mund me shifrat 124-123 nga Sacramento. Curry e Wiggins realizuan nga 29 pikë secili për Warriorsin, por që s'mjaftuan, ndërsa për vendasit u dallua Fox me 29 pikë.

### SHKURT

#### Sylvinho, Asllanit: Mos u largo nga Interi

Kristjan Asllani këtë sezon po gjen më shumë minuta në fushën e lojës nën urdhrat e trajnerit Simone Inzaghi. Derisa mesfushori po gjen gjithnjë e më shumë hapësira te "Nerazzurrët", ai ka qenë elementi kryesor prej disa kohësh edhe në kombëtaren shqiptare. Për formën e tij ka folur edhe trajneri i Shqipërisë, Sylvinho. Tekniku brazilian e ka këshilluar Asllanin që të mos largohet nga Interi. "Nuk do t'i thosha kurrë të largohej nga Interi për të luajtur më shumë. Më intereson se çfarë bën në kombëtare dhe ai ka treguar se është shumë i fortë", ka thënë trajneri i intervistuar nga Cronache di Spogliatoio.

#### Trajneri i Dortmundit: Për fitore edhe ndaj PSG-së

Borussia Dortmundi arriti një fitore të madhe në "San Siro" përballë Milanit (1-3). Nënkampionët e Gjermanisë siguruan edhe kualifikimin. Trajneri i verdhezinjve, Edin Terzić nuk e fsheh lumturinë për fitoren në Milano, ndërkohë që premtën se djemtë e tij do të tentojnë tri pikët edhe përballë skuadrës së Luis Enrique. "Nuk duam të bëjmë asnjë dallim mes ndeshjeve të ndryshme: do të luajmë për të fituar. Nuk duam t'u dhurojmë asgjë PSG-së, Newcastle dhe Milanit. Do të vijmë 80 mijë njerëz në stadium dhe ne mund ta sigurojmë vendin e parë. Kështu që do të japim gjithçka. Unë jam gjithmonë shumë i motivuar", ka thënë Terzić.

#### Haalandi thyen edhe një rekord në Ligën e Kampionëve

Erling Haaland po vazhdon të thyejë rekorde. Ylli norvegjez e realizoi njërin prej tre golave në fitoren me rezultat 3-2 ndaj Leipzigut. Me këtë rast, 23-vjeçari arriti në kuotën e 40 golave nga 35 ndeshje të zhvilluara. Këtë ai e ka arritur me tri klube, me Salzburgun, Borussia Dortmundin dhe kampionin aktual evropian. Kështu, Haaland u bë lojtari më i ri në histori të Ligës së Kampionëve që i shënon 40 gola në këtë garë prestigjioze. Ai ishte njëri prej kandidatëve kryesorë për ta fituar Topin e Artë sivjet, por përfundoi i dyti pas Lionel Messit. Haalandi e pati një sezon fantastik duke i fituar tre trofe me "Citizens", Ligën e Kampionëve, Premierligën dhe FA Cup.

#### Nantes shkarkon trajnerin Pierre Aristouy

Ndryshim bankine në Ligën 1. Drejtuesit e Nantes kanë shkarkuar Pierre Aristouy nga pozita e trajnerit. 43-vjeçari qëndronte në bankinën e Nantes prej datës 9 maj, duke drejtuar skuadrën për 17 ndeshje në total. Nantesi ka siguruar vetëm një pikë në katër takimet e fundit, ecuri negative që ka sjellë shkarkimin e Aristouy. Drejtuesit nuk duan të përjetojnë ankthet e sezonit të fundit, kur qëndrimi në elitë u siguroi vetëm në fund. Ai që pritet të zëvendësojë Pierre Aristouyn në bankinë është Jocelyn Gourvennec, i cili aventurën e fundit e pati te Lille.

## Xavi me çdo kusht e dëshiron Kimmichin

Ylli i Bayern Munchenit, Joshua Kimmich, është synim kryesor i trajnerit të Barcelonës, Xavi Hernandez. Prestigjiozja

spanjolle "AS" pohon me bindje se klubi spanjoll e ka seriozisht interesimin për shërbimet e tij. Xavi ia ka bërë të qartë

presidentit katalanas Johan Laporta se e do me patjetër "regjisorin" e rekordmenëve gjermanë, pavarësisht koston.

Kontrata me "bavarezët" skadon në vitin 2025 për Kimmich dhe nuk përjashtohet mundësia e largimit, aq më tepër kur

kritikat, krahas lojës së 28-vjeçarit, janë rritur. Kimmich vlerësohet sipas "transfermarkt" në kuotën e 75 milionë eurove.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Green Power" Sh.p.k – Rahovec në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Seperimin e shkëmbit gëlqeror të mërmerizuar - Komuna Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.01.2024 në ora 10:00 në objektin e Kuvendit Komunal të Rahovecit, do të organizohet Debat Publik nga Kompania "Green Power" Sh.p.k – Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us05web.zoom.us/j/6491479996?pwd=ZDv10hEpArxAW6QLU6xcjpps9XQMqi.1&omn=86011232749>

Meeting ID: 649 147 9996  
Passcode: 3QrGJe

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Green Power" Sh.p.k – Rahovec, për Seperimin e shkëmbit gëlqeror të mërmerizuar - Komuna Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Building 4 Future" SH.P.K. me seli në Prishtinë, me pronar Qëndrim Bajraktaraj ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811924861 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Building 4 Future" D.O.O. Pristina, sa vllasnikom Qëndrim Bajraktaraj donelo odluku o prestani rada sa nr. 811924861 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Building 4 Future" L.L.C. with headquarters Prishtinë, with owner Qëndrim Bajraktaraj has come to the decision to quit its business: 811924861 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agim Dushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Amarildo Kola shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të shkollës së mesme Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Bylbyl Feraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Zana Rexha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Florstina Hoxhaj shpall të pavlefshme dëftesën e Sh.F.M.U "Ali Hasi" Cermjan, KK Gjakovë.

- Zana Rudi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 dhe diplomën e Sh.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

- Astrit Jetishi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 të shkollës së mjekësisë "HysniZajmi", Gjakovë.

- Shukri Ferizi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".

Hana Gjemajlaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 dhe 12, të shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

